

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Nezihe Kazani, e bija e Riza Alizoti dhe e Vera Ypit, lindur në Tiranë më 3.11. 1942 dhe banues në Tiranë, rruga “Pjetër Bogdani”, Pallati 20/4, shk.1, ap.9/c.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të Hysen Fehim Zavalanit dhe Dalip Fehim Zavalanit, lindur më 1898 dhe 199 në Korçë dhe;

2. Emërimin e një kujdestari për grumbullimin dhe administrimin e pasurisë së tyre.

Baza ligjore: nenet 15 e 16 të Kodit Civil dhe nenet 375 e vij. të K.Pr.C.

Kërkuesja është një nga personat e afërt të Hysen dhe Dalip Zavalanit, bij të Fehim Qazim Frashërit dhe të Qerimesë, sepse nëna e kërkueses, është mbesë e tyre.

Të dy personat e sipërm janë larguar nga Shqipëria qysh prej shumë vjetësh. Hysen Zavalani është larguar nga Shqipëria rreth vitit 1917 dhe ka shkuar në Rusi për studime prej nga nuk u kthye më, kurse Dalipi u largua nga Shqipëria qysh nga viti 1920 duke shkuar në Berlin, Gjermani, ku mbaroi Universitetin.

Duke qenë se qysh nga ajo kohë familja nuk ka asnjë njoftim prej tyre, kërkojmë që në bazë të dispozitave të mësipërme t’i shpallë të zhdukur Hysen Fehim Zavalanin dhe Dalip Fehim Zavalanin.

KËRKUESJA
Nezihe Kazani